



# Depozitimi i sigurt i mbetjeve farmaceutike- programet e kthimit te ilaceve

(Resource ID: 301)

**Mimoza Pira**

mimoza.pira(at)riinvest.net

This teaching resource is allocated to following University:

**RIINVEST - Riinvest College**

Institution:

**Riinvest**

<http://www.sustainicum.at/sq/modules/view/301.Depozitimi-i-sigurt-i-mbetjeve-farmaceutike-programet-e-kthimit-te-ilaceve>



Puna ne grup



11 deri ne 30  
studente



deri ne 1  
semester



Anglisht, Shqip

Ju lutem, vini re: modulet shtese- kerkohen me shume se 7 njesi leksionesh!



Qellimi i ketij burimi eshte te rriti ndergjegjesimin e problemit te ilaceve te skaduara apo te paperdorshme. Duhet te mendojme se cfare ndodh me ilacet e skaduara qe mblidhen tek magazina qendrore e MSH, Farmacive Qendrore, farmacive lokale dhe gjithashtu te pyesim edhe se cfare ben konsumatori me ilacet e skaduara apo te paperdorshme. Industria farmaceutike zhvillohet,

prodhon dhe tregeton ilace dhe gjera te tjera farmaceutike per t'u perdorur si medikamente. Kur ky ilac nuk perdoret me nga pacientet, atehere kthehet ne mbetje dhe duhet hedhur apo depozituar diku, duke u perpjekur te gjejme menyren me te mire te mundshme per ta bere kete gje. Pikerisht ne kete pike fokusohet edhe ky burim i mesimdhenies . Studentet do te japin idete e tyre gjate periudhes para-punes ne terren , do te mbledhin informacion gjate fazes ne terren dhe do te prezantojne gjetjet e tyre dhe rezultatet gjate periudhes perfundimtare.

Menaxhimi i zinxhirit te furnizimeve eshte nje teme qe eshte e mire pershkruar dhe i jepet studenteve gjate studimeve te tyre. Duke folur per sektorin farmaceutik, menaxhimi i zinxhirit te furnizimit eshte i mireorganizuar duke filluar me sektorin publik, me ate privat dhe tek konsumatori.

Industria farmaceutike zhvillohet, prodhon dhe tregeton ilace ose farmaceutike per perdorim si ilace. Kur ky ilac nuk perdoret nga pacientet, kthehet ne nje mbetje dhe duhet te depozitohet duke siguruar te gjejne menyren me te mire te mundshme te berjes se saj.

*Cilat jane rekomandimet e FDA per largimin e ilaceve te paperdorura nga shtepia?*

Zgjidhja me e mire eshte programi i kthimit te ilacit ose perdorimi i kolektoreve te autorizuar si Agjensia DEA, SHBA. Vendet e autorizuar te mbledhjes mund te perfshijne farmacite e shitjes, farmacite e spitalit ose klinikes, dhe vendndodhjen e zbatimit te ligjit. Disa farmaci mund te ofrojne zarfa per te kthyer me poste pas ilacet e paperdorura permes postes. Pasi jane mbledhur, keto ilace depozitohen. Ka shume metoda per secilin lloj te ilaceve, por cdo vend vendos metodat qe do te japin me mire rezultat per ta.

Kthimi mbrapsh ose programi i kthimit me ane te postes nuk eshte i vlefshem ne vendin tone. Shumica e ilaceve te paperdorura ose te skaduara thjesht hidhet ne koshin normal te mbeturinave ne shtepi. Ulja e riskut te demtimit nga ekspozimi aksidental ne kete vend te vogel eshte themelor. FDA dhe Agjensia e Mbrojtjes Mjedisore ne SHBA pershkruan metoda te ndryshme qe jane me te sigurta per humanet dhe mjedisin.

Palet e interesit jane te identifikuar si Ministria e Shendetesise, Prodhuesit farmaceutike, farmacite e komunitetit dhe konusmatore te rastesishem. Do te zhvillohet nje vizite tek nje prodhues farmaceutik ne Kosove per te

diskutuar per menytrat e mbetjeve farmaceutike. E njejta gje do te behet tek Magazina Qendrore tek Ministria e Shendetesise. Ne vend qe te marrin informacion per metodat e depozitimit qe ata aplikojne, ne do te promovojme programin e marrjes mbrapsht qe eshte i aplikueshem ne vendet e zhvilluara.

Plani eshte te shkohet permes te gjitha fazave ne punen ne terren. Pjesemarresit do te sigurohen me pritshmeri te qarta dhe do te motivohen per te marre nje rol aktiv ne proces.

Metoda qe do te perdoret ne punen ne terren, do te kaloje gjithe nivelet. Zakonisht ka tre faza te perfshira ne punen ne terren. Faza para terrenit, faza ne terren dhe faza pas terrenit. Pjesemarresit do te sigurohen me pritshmeri te qarta dhe do te motivohen te marrin nje rol aktiv ne proces.

Gjate fazes para terrenit, qe do te mbahet ne klase, studentet do te japin opinionin e tyre me njohurite e tyre per mbetjet farmaceutike dhe do te flasin per pervojat e tyre se cfare bejne ne shtepi me medikamentet e skaduara ose te paperdorura. Pas gjithckaje, ata do te marrin informacion per temen qe po diskutohet dhe meodat kontemporane qe po perdoren ne vendet e zhvilluara, permes nje prezantimi me power point nga lektori.

Gjate fazes ne terren, studentet do te ken shansin te shikojne cfare po ndodh me medikamentet. Vizita e pare do te behet tek prodhuesit Trepharm Pharmaceuticals. Se bashku me lektorin, studentet do te shoqerohen nga nje person i Trepharm, i cili do te prezantoje studentet me procesin e prodhimit dhe cfare ndodh me materialet e mbetjeve ne fabrike. Ata do te informohen per planet e se ardhmes nese ka te tilla. Studentet do te motivohen te bejne pyetje dhe te japin opinionin e tyre.

Pas Trepharm, studentet do te vizitojne magazinën qendrore ne Prishtine, ku do te marrin informacion per cfare po ndodh me ilacet e skaduara, si eshte komunikimi me farmacite qendrore dhe shperndaresit qe furnizojne magazinën qendrore. Ata gjithashtu do te informohen se cfare ndosh me ilacet e skaduara nga rajoni, a i kthejne keto ilace ne piken qe i shperndan ato apo i depozitojne ato individualisht, me metoda alternative?

Gjate periudhes post terren, te dhenat e fituar nga puna ne grup do te mblidhen dhe analizohen. Ne grupe te vogla, studentet do te prezantojne ato qe kane hasur duke perdorur grafike, tabela dhe literaturen mbeshtetese.

---

# Mjetet e mësimdhënies



Mini-projekt për studentët   Field study   Case study   Material i shkruar

## Integrimi i palëve të interesuara shoqërore

Roli i palëve të interesit në këtë model është të na sigurojë informacion për të ndryshuar mënyrën e depozitimit të farmaceutikëve të padëshiruar.

- Ministria e Shëndet, Drejtori i departamentit farmaceutik
- Prodhuesit farmaceutikë në Kosovë ( Trepharm, Gentipharm)
- Farmacisti i komunitetit
- Konsumatorë të rastësishëm

## Pika e forte

- Lejon studentet të ekspozohen në mjedise të reja me qëllim që të rriti thellesinë e tyre të të kuptuarit
- Eksperince direkte që është kritike për zhvillimin e aftësive
- Inkurajon studentet për të vlerësuar peisazhe të ndryshme dhe ndihmon të njohi rëndësinë e ruajtjes së mjedisit.
- Demonstron lidhje
- Studentet do të kenë disa ide për mbetjet farmaceutike, çfarë duhet të bëjnë në të ardhmen dhe do të jenë një burim i madh i informacionit për të tjerët, në të njëjtën kohë.

## Pika e dobët

- Vështiresi për të rregulluar një takim me palët e interesit
- Mungesë e dëshirës nga palët e interesit për të bashkëpunuar dhe të jenë të përfshirë.
- Është vështirë për të punuar rreth orarit të studentëve.

## Rezultatet e të mësuarit

- të kuptohet si depozitohen gjërat farmaceutike (të skaduara apo të përdorshme)
- të rritet ndergjegjesimi i metodave të sigurta për përdorim në vendet e zhvilluara
- të rritet ndergjegjesimi i depozitimit të sigurt në koshat e plehrave shtëpiake
- të raportojë mbetjet farmaceutike

- te mbledhe dhe analizoje te dhenat
- te identifikojë vështësitë në zbatimin e protokolleve të mbetjeve farmaceutike
- te prezantoje gjetjet tek audiencia
- te vlerësoje ceshtjet e qëndrueshmërisë në zinxhirin furnizues të kompanive në sektorin farmaceutik

## Lidhja për qëndrueshmëri

Kjo ka lidhje direkt me sigurinë dhe mbrojtjen e ambjentit:

- pengon helmimin e fëmijëve dhe kafsheve shtëpiake
- pengon keqpërdorimin nga adoleshentët dhe të rriturit
- pengon problemet shëndetësore nga marrja aksidentale e ilaçeve të gabuara, sasi të mëdha të ilaçit ose një ilaç shumë të vjetër për të dhënë rezultate pozitive
- mban ilaçet larg nga perrenjtë dhe lumenjtë, kur derdhen në tualet për të kaluar përmes kanaleve të ujërave të zeza.

## Njohuri paraprake

Asnjë lloj njohurie paraprake specifike nuk kërkohet?

## Përpjekjet e përgatitjes

Mesatare

## Përshkrimi i përpjekjeve të përgatitjes

Ka nevojë për një përpjekje mesatare, duhet ta rregullojmë sipas orarit të paleve të interesit.

## Aksesi

Free

## Gjykimi / vlerësimi

Do të ketë një vlerësim

## Kreditim/Certifikatë

25% e notes përfundimtare

## Financuar nga

This teaching resource, realised within the project ConSus, has been funded with the support of the TEMPUS of the European Union. The contents reflect the views of the authors, and the European Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.